



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



PËR/ZA/TO:	Bashkim Ramosaj- Kryetar i Komunës
CC:	Z. Bashkim Ramosaj- Kryetar i komunës
NGA/OD/FROM:	Ajne Iberhysaj- U.D për Barazi Gjinore
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Raporti – Janar –Qershor 2026


Duke u bazuar sipas Rregullores (QRK) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, komuna e Deçanit ka mbajtur **dy takime** të Mekanizmit Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore

Gjatë periudhës Janar- Qershor 2026, **Koordinatorja Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës në Baza Gjinore** znj. Ajne Iberhysaj ka organizuar dhe mbajtur **(2) takime të Mekanizmit Koordinues Lokal**, në të cilat janë trajtuar:

- Në periudhën Janar –Qershor janë raportuar 16 raste të dhunës në familje në Stacionin e policisë në Deçan
- koordinimi ndër- institucional për trajtimin e rasteve,
- planifikimi i aktiviteteve parandaluese dhe sensibilizuese,
- diskutimi i sfidave dhe nevojave për përmirësimin e reagimit institucional
- ligjërata informuese për nxënës dhe staf arsimor,
- diskutimeve mbi format e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore,
- informimit mbi mekanizmat institucionalë të mbrojtjes dhe raportimit të dhunës.

Në përputhje me Rregulloren (QRK) Nr. 01/2025:

- **Kryesuesi i Mekanizmit Koordinues Lokal paraqet raport të punës së paku një (1) herë në vit para Kuvendit Komunal të Komunës përkatëse.**
- Po ashtu, Kryesuesi paraqet **raport të punës çdo gjashtë (6) muaj** pranë Koordinatorit **Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje**, lidhur me zbatimin e planeve komunale të veprimit.



Takimi i I-rë i Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje



Në takimin e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje, moren pjesë gjithsej 15 veta (5 burra dhe 10 gra) përfaqësues të institucioneve përgjegjëse. Gjatë takimit u diskutua gjendja e rasteve të dhunës në familje në komunë, bashkëpunimi ndërinstitucional, si dhe u shqyrtua plani i punës dhe aktivitetet e parapara për vitin 2026.

Përfaqësuesi i Stacionit Policor në Deçan, Fekë Haklaj, bëri të ditur se nga 1 janari deri më 26 qershor 2026 janë raportuar gjithsej **16 raste** të dhunës në familje. Sipas tij, të gjitha rastet janë

trajtuar në koordinim me institucionet përgjegjëse, ndërsa gjashtë prej tyre janë raste recidiviste që lidhen me persona me çrregullime të shëndetit mendor.

Zëvendësprokurorja në Prokurorinë Themelore në Pejë dhe koordinatore për rastet e dhunës në familje, Arlinda Gacaferi-Nallbani, njoftoi se gjatë kësaj periudhe në regjion janë trajtuar 141 raste, prej të cilave 96 janë përfunduar, ndërsa të tjerat janë në procedurë.

Ajo theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Qendrën për Shëndet Mendor në Pejë, duke potencuar se mungesa e kapaciteteve në forenzikë, si dhe tërheqja e dëshmvive nga familjarët, shpesh e vështirësojnë vazhdimin e procedurave ligjore. Mbrojtësi i viktimave, Demë Hasanaj, ngriti shqetësimin për nevojën e angazhimit më aktiv të Qendrës për Punë Sociale në trajtimin e rasteve që kërkojnë veprime institucionale. Ai propozoi organizimin e një takimi me Kryetarin e Komunës, z. Bashkim Ramosaj, me qëllim forcimin e koordinimit dhe përmbushjen e përgjegjësiave ligjore nga të gjithë anëtarët e mekanizmit. Ndërkaq, Agnesa Vokshi bëri të ditur se Komuna e Deçanit ka mbështetur dy raste të dhunës në familje përmes subvencioneve, duke mbuluar shpenzimet e qirasë për viktimat. Në përfundim të takimit u miratuan këto rekomandime:

- * Organizimi i fushatave sensibilizuese në shkolla, duke filluar nga muaji shtator, me pjesëmarrjen e anëtarëve të mekanizmit.

- * Publikimi i materialeve vetëdijësuese kundër dhunës në familje dhe planifikimi i buxhetit për mbështetjen e rasteve.


- * Përmbushja e obligimeve financiare ndaj Shtëpisë së Sigurt në Pejë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Komuna e Deçanit mbetet e përkushtuar në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete për parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen e viktimave dhe krijimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë qytetarët.

<https://www.facebook.com/search/top?q=komuna%20e%20de%C3%A7anit>



Takimi i II-të i Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje

Trajnim për trajtimin e rasteve të dhunës psikologjike



Zyra për Barazi Gjinore të Komunës së Deçanit bashkëpunim me Shtëpinë e Sigurt në Pejë, kemi organizuar trajnimin me temën “Trajtimi i rasteve të dhunës psikologjike”, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore në Komunën e Deçanit gjithsej morën pjesë 15 veta (sipas gjinisë 11 gra dhe 4 burra).

Trajnimi u ligjërua nga Sandra G. Zakowski, Ph.D., psikologe klinike e licencuar dhe profesreshë e Psikologjisë Klinike në Illinois School of Professional Psychology në Chicago, e cila prezantoi qasje profesionale dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës psikologjike.

Përmes diskutimeve interaktive, analizës së rasteve praktike dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet pjesëmarrësve, u trajtuan sfidat dhe praktikat më të mira në adresimin e dhunës psikologjike. U theksua domosdoshmëria e ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve profesionale dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, duke vlerësuar se trajnime të tilla janë thelbësore për ofrimin e mbrojtjes dhe mbështetjes sa më efektive për viktimat e dhunës.

Zyra për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryetarit shpreh mirënjohje të veçantë për Sandra G. Zakowski, Ph.D., për profesionalizmin, ekspertizën dhe kontributin e saj në realizimin e këtij trajnimi, si dhe falënderon të gjithë anëtarët e Mekanizmit Koordinues për pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e tyre në forcimin e mekanizmave institucionalë për parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.



Bashkëpunimi, koordinimi dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale mbeten themeli i një sistemi mbrojtës që garanton siguri, dinjitet dhe mbështetje për çdo viktimë.

https://www.facebook.com/search/top?q=komuna%20e%20de%C3%A7anit&locale=en_GB

